



**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT**  
**KORÇË**  
**VENDIM**

Nr 44 Datë 19.07.07

**PËR**  
**NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË ADMINISTRATËN E**  
**BASHKISË**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, "PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS NË ADMINISTRATËN E BASHKISË", bazuar në ligjin nr 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "ç", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", V.K.M nr 551 dt. 07.11.2002, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore të ndryshuar", V.K.M nr. 355 dt. 14.06.2006 "Për disa ndryshime në Vendimin nr 551 dt. 07.11.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e Njësive të Qeverisjes Vendore për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të Qeverisjes Vendore të ndryshuar", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 i M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.B. nr 3 dt. 02.02.2007 "Për miratimin e strukturës dhe pagave të administratës së Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë ndryshimin e strukturës të administratës, duke shtuar 7 punonjës si me poshtë:

- |                                                                      |        |
|----------------------------------------------------------------------|--------|
| • Zv.Kryetar                                                         | 1(një) |
| • Shef Kabineti                                                      | 1(një) |
| • Këshilltar                                                         | 2(dy)  |
| • Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë e të Ardhurave         | 1(një) |
| • Specialist i nivelit të lartë në Drejtorinë Juridike               | 1(një) |
| • Përgjegjës i sektorit të legalizimeve në Drejtorinë e Urbanistikës | 1(një) |

2. Niveli i pagave për këtë shtesë në strukturën administrative do të jetë si më poshtë:

| Emertimi                                                             | Nr<br>punonjesve | Kategoria | Paga<br>grupit | Shtese per<br>vjetërsi | Shtesë për<br>pozicion | Kategori<br>fikse |
|----------------------------------------------------------------------|------------------|-----------|----------------|------------------------|------------------------|-------------------|
| Zv/Kryetar                                                           | 1                | P 9 b     |                |                        |                        | 81.428            |
| Shefi i kabinetit                                                    | 1                | I b       | 10.050         | 2 %                    | 44.514                 |                   |
| Këshilltar                                                           | 2                | II b      | 10.050         | 2 %                    | 33.657                 |                   |
| Dr.Ardhurave<br>(specialist i<br>nivelet të lartë)                   | 1                | III b     | 10.050         | 2 %                    | 22.052                 |                   |
| Dr. Juridike<br>(specialist i<br>nivelet të lartë<br>per prokurimet) | 1                | III b     | 10.050         | 2 %                    | 22.052                 |                   |
| Dr.Urbanistik.<br>(përgjegjës i<br>sektorit të<br>legalizimeve)      | 1                | III b     | 10.050         | 2 %                    | 26.871                 |                   |

3. Efektet financiare do të përballohen nga fondi i planifikuar i pagave i llogaritur në buxhetin e Bashkisë për vitin 2007.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes ne Bashki.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetare e Këshillit**

*Raimonda NASE*  
**Raimonda NASE**